

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 I Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administrates shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), si dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17) ministri i Arsimit dhe Shkencës përcaktoi Program mësimor për **Arsim qytetar** për klasën e IX-të të arsimit fillor nëntëvjeçar.



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

PROGRAMI  
MËSIMOR

**ARSIM QYTETAR**

KLASA E IX-TË

Shkup, tetor 2018

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

## 1. PARATHËNIE

Në planin mësimor për arsimin fillor nëntëvjeçar, lënda mësimore *Arsim qytetare* mësohet në periudhën e tretë zhvillimore me status të lëndës së obligueshme në klasën e VIII dhe IX me nga një orë në javë, gjegjësisht 36 orë në vit.

Duke marrë parasysh faktin se lënda mësimor *Arsim qytetar* mësohet në periudhën e fundit të arsimit fillor, në programet mësimore janë dhënë qëllimet zhvillimore për periudhën, në bazë të të cilave konkretizohen qëllimet dhe përmbajtjet në secilën klasë.

Programi mësimor i *Arsimit qytetar* është përpiluar me rezultate të përcaktuara qartë nga nxënia. Arsimi qytetar në Republikën e Maqedonisë orientohet drejt zhvillimit të kompetencave që kanë të bëjnë me gjithë atë që pritet ta dinë nxënësit, të kuptojnë ose të dinë të bëjnë ose të pranojnë një sistem të vlerave të nevojshme për të funksionuar si qytetarë demokratik dhe aktiv. Mësimi i arsimit qytetar do të kontribuojë që nxënësit të angazhohen për zhvillimin e bashkësisë dhe të jenë persona kompetentë të aftë për të bërë zgjedhje për zhvillimin personal në shoqërinë bashkëkohore.

Programet e reja mësimore nga lënda *Arsim qytetar* i reflektojnë ndryshimet në qasjet në mësimin e arsimit qytetar në Evropë dhe botë. Ato janë të orientuara drejt aftësimit të nxënësve për pjesëmarrje aktive në jetën e shkollës dhe zhvillimin e interesit dhe kompetencës për përfshirje në proceset e vendimmarrjes për bashkësinë. Metodatat që do të përdoren në mësim nga arsimi qytetar duhet të kontribuojnë në zhvillimin e individit dhe vlerave themelore të njeriut, lirinë individuale, integritetin, dinjitetin dhe të drejtat e barabarta për krijimin e kushteve për forcimin e ndjenjës së drejtësisë, tolerancës dhe përgjegjësisë, si dhe për përgatitjen e nxënësve për jetë të përgjegjshme në shoqëri demokratike qytetare.

Me programin mësimor janë parashikuar mundësi për punë të individualizuar dhe grupe të nxënësve që kontribuon në të menduarit të pavarur dhe kritik dhe zbatimin e diturive të përvetësuara, kuptimeve, shkathëtise, qëndrimeve, interesave, vlerave dhe sjelljen qytetare në aktivitetet në shumë çështje nga fusha e arsimit qytetar. Natyra e lëndës mësimore parashikon respektimin e parimeve të mësimit bashkëkohor interaktiv, punë e përgatitur mirë grupe e nxënësve në mësim që të mbështetet aftësia inventive e secilit nxënës gjatë përpunimit të përmbajtjeve dhe aktiviteteve hulumtuese me ndjekjen e vazhdueshme e të arriturave të secilit nxënës nga arsimtari.

## 2. QËLLIME TË LËNDËS PËR PERIU DHËN ZHVILLIMORE (VIII-IX)

### Nxënësi/nxënësj:

- t'i njuh dhe t'i përkufizojë kuptimet themelore që kanë të bëjnë me shoqërinë qytetare,
- t'i respektojë dinjitetin e njeriut dhe të drejtat e njeriut si vlera të mbështetura në bindjen e përgjithshme se secili njeri është po aq i rëndësishëm, i vlefshëm për respekt dhe i takojnë të drejtat dhe liritë e njëjta,
- t'i vlerësojë demokracinë, korrektësinë, drejtësinë, barazinë dhe ligjshmërinë si parime mbi të cilat funksionojnë shoqëritë bashkëkohore,
- t'i respektojë diversitetin dhe llojllojshmërinë kulturore, pluralizmin e pikëpamjeve dhe dallimeve në sjellje,
- të zhvillojë transparencë dhe ndjeshmëri ndaj dallimeve kulturore, besimeve, pikëpamjeve për botën dhe sjelljen e të tjerëve,
- të zhvillojë vetëdije qytetare, ndjenjë të përkatësisë ndaj bashkësisë, vetëdije për njerëzit tjerë në bashkësinë dhe për ndikimin e veprimeve personale ndaj atyre njerëzve, solidaritet dhe ndjenjë të përgjegjësisë qytetare ndaj bashkësisë,
- të tregojë përgjegjësi për veprimet dhe vendimet personale përmes veprimit moral, veprimit të vetëdijshëm dhe përgjegjësi për pasojat nga procedurat,
- të besojë në aftësitë personale për ndërmarrjen e veprimit në arritjen e qëllimeve të caktuara,
- të zhvillojë shkathtësi për mendim analitik dhe kritik, gjegjësisht të analizojë në mënyrë sistematike dhe logjike, të vlerësojë dhe të marrë vendime në bazë të argumenteve,
- të tregojë eupati ndaj të tjerëve që t'i kuptojë mendimet, besimit dhe ndjenjat e njerëzve të tjerë dhe ta shikojë botën nga perspektiva e tyre,
- të mësojë bashkëpunimin me interes të përgjithshëm dhe publik në shoqërinë qytetare, duke përfshirë jetesën në mjedis të shëndoshë jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm,
- të bashkëpunojë me të tjerët në aktivitete, detyra dhe ngjarje të përbashkëta dhe t'i nxisë në bashkëpunim për arritjen e qëllimeve të përbashkëta,
- t'i zgjidhë konfliktet në mënyrë paqësore përmes orientimit të palëve të konfliktit drejt zgjidhjeve optimale dhe konstruktive që janë të pranueshme për të gjithë,
- të synojë drejt vetënjuhjes dhe vetëkuptimit, që përfshin dituri dhe kuptim kritik të mendimeve, besimeve, ndjenjave dhe motiveve personale, si dhe në kontekst të përkatësisë personale kulturore dhe perspektivës më të gjerë shoqërore,
- të praktikojë komunikim konstruktiv dhe efektiv dhe interaksion me të tjerët,
- të ndërtojë dituri për botën dhe të kuptuarit e botës në fusha të ndryshme, duke përfshirë: ekonominë, religjionin, mediat, historinë, kulturën, të drejtat e njeriut, politikën, të drejtën,

- të demonstrojë mjete demokratike për participim në të gjitha nivelet dhe të merr pjesë aktive si individ, anëtar i grupeve ose si pjesë e shoqërisë,
- të dallojë perspektivë evropiane dhe ndërkombëtare prej aspekteve të ndryshme,
- t'i mësojë vlerat e përbashkëta evropiane dhe përfitimet nga integrimet në organizatat ndërkombëtare dhe Bashkimin Evropian.

### 3. QËLLIMET MËSIMORE NË KLASËN E IX-TË

#### Nxënësi/nxënësjatë:

- hulumtojë dhe sqarojë dukuri shoqërore nga mjedisi i drejtpërdrejt dhe në interes të jetës së nxënësve/moshatarëve;
- sqarojë faktorët e ndryshëm shoqëror që ndikojnë në zhvillimin e identitetit qytetar dhe sjelljen e individit;
- kuptojë rëndësinë e qëndrimeve dhe vlerave morale në jetën shoqërore dhe personale dhe të sillt në përputhje me normat e pranuar morale;
- njohë mundësitë dhe shtigjet për arsimim dhe faktorët për përzgjedhjen e profesionit;
- identifikojë dhe pranojë ngjashmëri dhe dallime të ndryshme kulturore, religjioze, sociale dhe etnike të njerëzve në bashkësi;
- sqarojë dhe mbrojnë qëndrimet e tij/saj dhe të tregojë mirëkuptim për pikëpamjet e ndryshme;
- dallojë lloje të ndryshme të konflikteve dhe të sqarojë dhe përdorë mënyra të ndryshme për parandalimin dhe zgjidhjen e tyre në mënyrë të padhunshme;
- tregojë gatishmëri për pjesëmarrje aktive në ndërtimin e shoqërisë interkulturore;
- përshkruajë sjelljen e qytetarëve në shoqëri;
- dallojë sjelljen e përgjegjshme nga ajo e papërgjegjshme dhe të kuptojë nevojën e përgjegjësisë sociale;
- të kuptojë rëndësinë e organizatave dhe grupeve qytetare të përfaqësimit që punojnë në aktivitete për ndryshime pozitive në shoqërinë qytetare;
- kuptojë, funksionet dhe karakteristikat e kulturës në shoqërinë qytetare dhe elementet e identitetit kulturor;
- sqarojë rolin e religjionit në shoqërinë bashkëkohore dhe të kuptojë procesin e shekullarizimit të shteteve;
- kuptojë rolin dhe ndikimin e mediave masive, propagandës mediatike dhe mediave sociale në shoqërinë bashkëkohore;
- ndërtojë raport të përgjegjshëm ndaj shfrytëzimit të mediave sociale;
- sqarojë rëndësinë e sundimit të së drejtës dhe funksionimin e shtetit juridik dhe t'i respekton normat juridike;
- demonstrojë përgjegjësi qytetare dhe të reagojë drejtë ndaj situatave në të cilat manifestohen korrupsioni, jo etika dhe presioni social;
- dallojë mënyrat në të cilat qytetarët marrin pjesë në vendimmarrjen demokratike përmes zgjedhjeve;
- përfshihet në zgjedhjet dhe punën e bashkësisë së nxënësve;
- dallojë institucionet shtetërore/publike, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në shoqëri;
- sqarojë sfidat dhe përfitimet e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian nga aspekti i integritimit ekonomik, social, ndëretnik, ndërkulturor;
- identifikojë vlerat e përbashkëta evropiane dhe të dallojë bashkëpunimin në fusha të ndryshme mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bashkimit Evropian.

## 4. QËLLIME KONKRETE

Tema I: Identitet qytetar – 6 orë				
Qëllime	Përmbajtje	Kuptime/nocione	Aktivitete dhe metoda	Rezultate nga nxënia/mësimi
<p><b>Nxënësi/nxënësja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të sqarojë zhvillimin e veçorive personale, të bëjë dallimin mes veçorive të tij/saj dhe veçorive të të tjerëve;</li> </ul>	<p><b>Zhvillim i veçorive personale</b></p>	<p>Zhvillim Veçori</p>	<p>Përpilon T tabelë për veçoritë e tij/saj dhe të tjerëve</p> <p>Përpunon portret të individit me veçori pozitive dhe të dëshiruara</p> <p>Diskutim në Temën “Cilat veçori janë të dëshiruara dhe shpijnë drejt së mirës së përgjithshme”</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja është i aftë/e aftë të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizojë dhe vlerësojë zhvillimin e veçorive personale dhe i percepton përparimin, sukseset dhe sfidat;</li> <li>- vendosë qëllime reale që janë të përshtatura me veçoritë dhe mundësitë e tij dhe është i përgjegjës dhe këmbëngulës në arritjen e të njëjtave.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të di të dallojë vlera shoqërore dhe personale dhe të sqarojë se çfarë është etikë dhe humanitet;</li> </ul>	<p><b>Etika, vlera dhe humaniteti</b></p>	<p>Etikë Humanitet Vlerë</p>	<p>Përpilon “kalaveshin” ( Kllaster) në temën Vlerat</p> <p>Përpilim i materialit promovues në temën Etikë</p> <p>Ese në temën Humanitet</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruajë sjelljen në situata sensitive etike (dilema morale);</li> <li>- analizojë dhe vlerësojë mundësitë për aktivitet humanitar në nivel të shoqërisë dhe përfshirjen e tij në to;</li> <li>- marrë pjesë dhe mbështetë aksione humanitare dhe është vullnetarë në organizata humanitare.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë rëndësinë dhe nevojën për mësim gjatë gjithë jetës;</li> <li>- të shqyrtojë nevojën e planifikimit të zhvillimit të tij/saj</li> </ul>	<p><b>Zhvillim profesional dhe në karrierë</b></p>	<p>Plan Karrierë Zhvillim Profesion Mësim i përjetshëm</p>	<p>Bën plan personal për zhvillim në karrierë</p> <p>Në T tabelë i shënon anët e tij/saj të forta dhe të dobëta</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- hulumtojë mundësitë për vazhdimin e arsimimit dhe ndikimit të tyre në përzgjedhjen e profesionit.</li> <li>- demonstrojë qëndrim pozitiv ndaj</li> </ul>

<p>profesional dhe në karrierë; - t'i identifikojë përparësitë e tij/saj dhe anët e forta në zhvillimin.</p>			<p>për zhvillimin e ardhshëm në karrierë</p> <p>Hulumtim i mundësive për regjistrim në arsimin e mesëm përmes analizës së Konkursit të shkollave të mesme publike dhe private.</p>	<p>mësimits përmes shembujve që dëshmojnë nevojën e mësimit gjatë tërë jetës; - vendosë qëllime reale për mësim dhe përparim personal.</p>
--	--	--	--	--



**Tema II: Bashkëpunimi dhe ndërlidhshmëria në shoqërinë qytetare – 8 orë**

Qëllime	Përmbajtje	Kuptime/nocione	Aktivitete dhe metoda	Rezultate nga nxënia/mësimi
<p><b>Nxënësi/nxënësja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të di t'i dallojë dhe sqarojë ngjashmëritë dhe dallimet në raport me përkatësinë etnike, fetare, sociale, gjinore, racore;</li> <li>- të sqarojë se çfarë është diskriminimi dhe të ndërtojë qëndrim kritik ndaj të njëjtit;</li> <li>- të iniciojë aktivitete që promovojnë pranim, respektim të dallimeve dhe bashkëpunim të ndërsjellë.</li> </ul>	<p><b>Pranim dhe respektim i diversiteteve</b></p>	<p>Diversitete Diskriminim Tolerancë</p>	<p>Aktivitete me role të caktuara</p> <p>Diagrami i Venit Ngjashmëri dhe dallime (etnike, fetare, kulturore, sociale ...)</p> <p>Punë në grupe – teknika mësimore- prizma</p> <p>Punë në projekte për aksion shoqëror</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja është i aftë/e aftë të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- diskutojë respektimin dhe mosrespektimin e dallimeve në bazë etnike, fetare, gjinore, sociale përmes shembujve konkret;</li> <li>- analizojë shembuj të diskriminimit në kushtet e jetesës bashkëkohore;</li> <li>- propozojë dhe merr pjesë në aktivitete konkrete që promovojnë respektim të dallimeve dhe bashkëpunimit.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të sqarojë se njerëzit kanë të drejtën e mendimeve, qëndrimeve dhe pikëpamjeve të tyre;</li> <li>- të di të hulumtojë pikëpamje të ndryshme për një situatë.</li> </ul>	<p><b>Qëndrime dhe pikëpamje</b></p>	<p>Qëndrime Pikëpamje</p>	<p>Bën vizatim në temën : Pikëpamje të ndryshme</p> <p>Lojë me role ose debat - Mbrojtje e qëndrimit vetanak në një temë të caktuar</p> <p>Krijimi dhe administrimi i një grupi të caktuar diskutuesish në rrjetë sociale rreth çështjeve të arsimit qytetar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- prezantojë dhe diskutojë mendime, qëndrime dhe pikëpamje që i shprehin njerëzit për temë konkrete;</li> <li>- respektojë pikëpamje të ndryshme që i kanë të tjerët për një temë të caktuar;</li> <li>- diskutojë shembuj të tolerancës për pikëpamje të ndryshme.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojë lloje të konflikteve në shoqëri;</li> <li>- të sqarojë zgjidhjen konstruktive të konflikteve;</li> <li>- konfliktet dhe kontestet t'i zgjidhë në mënyrë konstruktive.</li> </ul>	<p><b>Konflikte dhe përballje me konflikte</b></p>	<p>Konflikt Kontest Konfrontim</p>	<p>Punë në çifte – Identifikim i situatave konfliktuoze dhe gjetje të zgjidhjes</p> <p>Grumbull-Elemente të konflikteve Luajte rolesh – zgjidhje të konfliktit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përcaktojë dhe grupojë lloje të konflikteve në situata konkrete të konfliktit;</li> <li>- analizon situata potenciale të konfliktit në grupin e moshatarëve;</li> <li>- propozojë mënyra dhe forma për zgjidhje konstruktive të konflikteve;</li> <li>- propozojë aktivitete që promovojnë jodhunë në shkollë.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i sqarojë multikulturalizmin dhe interkulturalizmin si dukuri;</li> <li>- t'i sqarojë elementet e shoqërisë interkulturore.</li> </ul>	<p><b>Interkulturalizmi në shoqërinë qytetare</b></p>	<p>Interkulturalizëm vlera interkulturore</p>	<p>DDM teknika (Di, dua të di dhe mësoj)</p> <p>Debat në temën: Interkulturalizmi përballë multikulturalizmit</p> <p>Teknika mësimore - pesvargëshi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- bëjë dallimin mes multikulturës dhe interkulturës;</li> <li>- dallojë elemente të shoqërisë interkulturore;</li> <li>- realizojë aktivitete konkrete që kontribuojnë në ndërtimin e vlerave interkulturore.</li> </ul>

**Tema III: Qytetari në shoqërinë qytetare – 5 orë**

Qëllime	Përmbajtje	Kuptime/nocione	Aktivitete dhe metoda	Rezultate nga nxënia/mësimi
<p><b>Nxënësi/nxënësja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përshkruajl sjelljen e qytetarëve në shoqëri;</li> <li>- të dallojë sjelljen e përgjegjshme nga ajo e papërgjegjshme;</li> <li>- të kuptojë nevojën e përgjegjësisë sociale.</li> </ul>	<p><b>Përgjegjësi sociale</b></p>	<p>Përgjegjësi sociale Papërgjegjësi</p>	<p>Debat në temën: Role të ndryshme dhe sjellja e njerëzve</p> <p>Përpunim i materialit promovues në temën: përgjegjësi sociale</p> <p>Punë në grup – Planifikim i iniciativave për përmirësimin e jetës në shkollë dhe bashkësi.</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja është i aftë/e aftë të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizojë dhe diskutojë në mënyrë kritike për role dhe sjellje të ndryshme të qytetarët;</li> <li>- dallojë se çfarë është përgjegjësi sociale në shkollë dhe bashkësi;</li> <li>- angazhohet në situata në të cilat nevojitet përgjegjësi sociale;</li> <li>- marrë pjesë dhe iniciojë aktivitete për përmirësimin e jetës në shkollë dhe bashkësi.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të identifikojë llojet e organizimit dhe shoqërimit;</li> <li>- të sqarojë rolin e organizatave qytetare në shoqëri;</li> <li>- të analizojmë përfitimet nga aktivitetet e organizatave qytetare dhe grupeve përfaqësuese.</li> </ul>	<p><b>Organizatave qytetare dhe grupet përfaqësuese</b></p>	<p>Organizata qytetare Grupe përfaqësuese Vullnetarizëm Bashkësi e nxënësve</p>	<p>Diskutim – arsyeja dhe kushtet për organizim dhe shoqërim qytetar.</p> <p>Hulumtim për organizata qytetare që veprojnë në shtetin tonë.</p> <p>Punë në grupe – formim i organizatave qytetare (Përpilojnë plan dhe program veprimi)</p> <p>Diskutim për punën e bashkësisë së nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- dallojë situata konkrete në të cilat qytetarët mund të ndikojnë në përmirësimin e jetës në bashkësi përmes bashkimit dhe organizimit;</li> <li>- hulumtojnë shembuj të iniciativave qytetare;</li> <li>- pranojë veprimin e qytetarëve përmes iniciativave qytetare (formale dhe joformale);</li> <li>- propozojë lloje të ndryshme të iniciativave për përmirësimin e jetës në shkollë dhe bashkësi.</li> </ul>

Tema IV: Kultura, identiteti kulturor, religjioni dhe mediat sociale -6 orë				
Qëllime	Përmbajtje	Kuptime/nocione	Aktivitete dhe metoda	Rezultate nga nxënia/mësimi
<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i kuptojë rëndësinë, ndikimin, funksionet dhe karakteristikat e kulturës në bashkësinë e tij/saj;</li> <li>- t'i sqarojë elementet që e përbëjnë identitetin kulturor.</li> </ul>	<b>Kultura dhe identiteti kulturor</b>	Identitet kulturor	<p>Projekt në temën: „Kulturat në bashkësinë time“</p> <p>Punë në çifte: intervistë e ndërsjellë dhe prezantim i tjetrit.</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja është i aftë/e aftë të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- hulumtojnë dhe prezantojnë kultura të ndryshme nga mjedisi i tij;</li> <li>- përkufizojë kuptimin identitet kulturor përmes një shembulli konkret.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë procesin e shekullarizimit të shteteve;</li> <li>- të sqarojë rolin e religjionit në shoqërinë bashkëkohore.</li> </ul>	<b>Roli i religjionit në shoqërinë qytetare</b>	Shekullarizëm Ateizëm	<p>Grumbull teknikash për përkufizimin e kuptimeve: shekullarizim dhe ateizëm</p> <p>Pyetje ese/diskutim: Roli i religjionit në shoqërinë qytetare</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- dallojnë dhe përkufizojë kuptimet: shekullarizim dhe ateizëm;</li> <li>- identifikojë vlerat e religjioneve që promovojnë vlera të përgjithshme njerëzore;</li> <li>- prezantojnë shembuj pozitiv të tolerancës ndaj atij me religjion tjetër dhe ateistëve.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të analizojë ndikimin e mediave, propagandës mediatike në shoqërinë bashkëkohore;</li> <li>- të ndërtojë raport të përgjegjshëm në shfrytëzimin e mediave sociale.</li> </ul>	<b>Ndikimi i mediave sociale ndaj qytetarëve</b>	Sajber dhunë Censurë Autocensurë	<p>Analizon tekst - identifikim i fakteve, informacionit dhe qëndrimit personal të gazetarit.</p> <p>Shembuj të ndikimit të mediave sociale në jetën e përditshme.</p> <p>Diskutim: shfrytëzim i (pa) përgjegjshëm i rrjeteve sociale</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- diskutojnë për nevojën e interpretimit kritik të mediave dhe propagandës mediatike;</li> <li>- sqarojë kuptimet censurë dhe autocensurë;</li> <li>- analizojë në mënyrë kritike shfrytëzimin e papërgjegjshëm të mediave sociale (sajber dhunë).</li> </ul>

			Shkrimi i tekstit të gazetarisë, artikullit ose postimit në ndonjë bllok në temën: censurë, autocensurë ose sajber dhunë.	
--	--	--	---	--

<b>Tema V: Qytetari dhe shteti – 6 orë</b>				
<b>Qëllime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Kuptime/nocione</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>	<b>Rezultate nga nxënia/mësimi</b>
<p><b>Nxënësi/nxënësja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të sqarojë kuptimin shtet juridik;</li> <li>- të identifikojë ndikimin e dëmshëm të korrupsionit në zhvillimin e individit, grupit dhe shoqërisë;</li> <li>- të analizojë mekanizma për mbrojtje nga veprimet korruptuese.</li> </ul>	<p><b>Sundimi i së drejtës dhe shtetit të së drejtës</b></p>	<p>Shtet i së drejtës Korrupsion Antikorrupsion Joetikë Presion social</p>	<p>Përpilim i fjalëkryqit me kuptimet kyçe, për shembull: presion social, integritet, korrupsion, antikorrupsion, etikë, përgjegjësi qytetare;</p> <p>Lojë rolesh /diskutim në temën: përgjegjësi qytetare, korrupsion, joetikë, presion social. Hulumtim i korrupsionit (notim jokorrekt) në shkollë</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja është i aftë/e aftë të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- numërojë karakteristika të shtetit juridik;</li> <li>- dallojë interesin publik nga ai privat dhe përmendë shembuj të sjelljes joetike në mjedisin e tij;</li> <li>- të dallojë presionin social në situata konkrete mes moshatarëve;</li> <li>- numërojë të drejtat e njeriut që janë shkelur në situata të korrupsionit;</li> <li>- vlerësojë se secili akt që ka për qëllim përfitimin personal në dëm të tjetrit është joetik dhe/ose i paligjshëm;</li> <li>- propozojë mënyra etike për t'u përballur me situata të presionit social.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- të sqarojë demokracinë si procedurë, mënyrë e të menduarit dhe veprimit;</li> <li>- të kuptojë lidhjen mes zgjedhjeve dhe proceseve demokratike në shoqëri;</li> <li>- të sqarojë se si përmes partive politike qytetarët i shprehin interesat e ndryshëm (pluralizëm).</li> </ul>	<p><b>Zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri</b></p>	<p>Demokraci Zgjedhje Referendum Pluralizëm politik Legjitimitet i pushtetit</p>	<p>Debat në temën: Nëse nuk votoj unë, dikush tjetër do të vendosë në emrin tim.</p> <p>Krahasim i programeve të partive politike me ç’rast përpilohet Diagram i Venit.</p> <p>Planifikim/mbajtje e zgjedhjeve për përfaqësues të nxënësve në paralelen/shkollën.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- organizojë, zbatojë dhe marrë pjesë në aktivitete zgjedhore të bashkësisë së shkollës;</li> <li>- respektojë rezultate të zgjedhjeve demokratike dhe vendime të shumicës në mjedisin e tij/saj;</li> <li>- analizojë veprimin e partive politike në shoqëri;</li> <li>- diskutojë pse është e rëndësishme të marrë pjesë në zgjedhje dhe si është kjo e ndërlidhur me legjitimitetin e pushtetit (shembuj konkret).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të sqarojë funksione dhe përgjegjësi të shtetit dhe administratës publike;</li> <li>- t’i përmendë organet themelore të vetëqeverisjes lokale dhe t’i ndërlidhë me përgjegjësitë e tyre.</li> </ul>	<p><b>Administrata shtetërore dhe publike në funksion të qytetarëve</b></p>	<p>Administratë shtetërore Administratë publike</p>	<p>Hartim i projektit grupor: „Administrata shtetërore dhe publike në funksion të qytetarëve“</p> <p>Hartë e mendimit: administrata shtetërore dhe publike</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- zbatojë funksione dhe përgjegjësi të administratës shtetërore dhe publike dhe të perceptojë dallime në situata konkrete;</li> <li>- të përmendë dhe diskutojë të drejtat e qytetarëve në bashkësinë e tij/saj lokale.</li> </ul>

**Tema VI: Qytetari dhe Evropa – 5 orë**

Qëllime	Përmbajtje	Kuptime	Aktivitete dhe metoda	Rezultate nga nxënia
<p><b>Nxënësi/nxënësja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të sqarojë krijimin e Bashkimit Evropian (BE);</li> <li>- t'i sqarojë strukturën, qëllimet dhe funksionimin e BE-së;</li> <li>- t'i dallojë dhe analizojë përfitimet dhe sfidat e vendeve-anëtare të BE-së.</li> </ul>	<p><b>Bashkimi Evropian (BE)</b></p>	<p>Këshilli i Evropës Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut Komiteti i ministrave Sekretariat i Parlamentit Evropian</p>	<p>Punë në grupe - Hulumtim i skemës organizative dhe kompetencave të organeve të BE-së</p> <p>Pyetje ese /diskutim: Obligimet dhe përfitimet për zhvillimin social dhe ekonomik të shteteve anëtare të BE-së</p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja është i aftë/e aftë të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruajë themelimin, zhvillimin e BE-së;</li> <li>- sqarojë funksionimin e BE-së përmes analizës së institucioneve të BE-së dhe kompetencave të tyre;</li> <li>- veçojë obligimet dhe përfitimet për zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve anëtare të BE-së.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të sqarojë raportin e Republikës së Maqedonisë Veriore dhe BE-së;</li> <li>- të dallojë bashkëpunimin mes RMV-së dhe BE-së në fusha të ndryshme.</li> </ul>	<p><b>Republika e Maqedonisë Veriore në Bashkimin Evropian</b></p>	<p>Integrim</p>	<p>Diskutim – Evropa kjo jemi ne</p> <p>Punë në grupe: Hulumtim i përfitimeve dhe obligimeve të RMV-së nga anëtarësimi në BE.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruajë bashkëpunimin mes RMV-së dhe BE-së;</li> <li>- identifikojë një pjesë të kushteve që duhet të përmbushen për anëtarësim në BE;</li> <li>- demonstrojë iniciativa konkrete të bashkëpunimit mes të rinjve nga RMV me të rinjtë nga shtetet anëtare të BE-së.</li> </ul>

## 5. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Programi mësimor është formësuar në përputhje me karakteristikat zhvillimore të nxënësve në klasën e IX-të të arsimit fillor nëntëvjeçar. Përmban elemente didaktike që janë karakteristike për mësimin e shkollës fillore bashkëkohore dhe të përshtatura me aftësitë psikofizike të nxënësit. Materiali mësimor është i sistematizuar në mënyrë logjike duke u mbështetur në shkencën bazike me teorinë e saj, metodë hulumtuese dhe logjikën e konstatimit.

Arsimtarët e arsimit qytetar planifikimet dhe përgatitjet e tyre për mësim duhet t'i zhvillojnë në bazë të qëllimeve dhe rezultateve nga nxënia sipas temave dhe përmbajtjeve mësimore me përzgjedhjen përkatëse të metodave dhe aktiviteteve në procesin mësimor. Planifikimi përfshin detyra që duhet të kryhen në kohë të caktuar për realizimin e qëllimeve të vendosura dhe rezultateve nga nxënia, por edhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të rezultateve të arritura. Me planifikimin evitohet spontaniteti në procesin edukativo-arsimor, e nga ana tjetër pikënisja përpilimin e planifikimit është reflektimi, që do të thotë se planifikimi si sistem i punës duhet të avancohet vazhdimisht.

Programi mësimor për klasën e IX-të ofron gjashtë tema zhvillimore mësimore që paraprkishtë mësohen edhe në klasën e VIII, për të cilat rekomandohet që të organizohet mësim bashkëkohor interaktiv.

Për shkak të specifikës së lëndës mësimore dhe lidhshmërisë së saj me jetën e përditshme të nxënësve në mësim duhet t'i kushtohet kujdes harmonizimit të përmbajtjeve programore dhe angazhimeve për shoqëri demokratike qytetare me metodat që përdoren dhe klimën e përgjithshme në orë (përgjegjësi, bashkëpunim, respekt, demokraci, etj.) Në fakt, është e domosdoshme që nxënësit të aftësohen për të zbatuar diturinë, të ndërtojnë qëndrime, interesa dhe mendime të tyre që do të kontribuojnë për të qenë aktiv, të pasurojnë pjesëmarrjen e tyre si nxënës dhe më pas ta avancojnë shoqërinë qytetare si qytetar të moshuar, ndërsa kjo arrihet më me sukses përmes përvojës personale.

Programi mësimor i arsimit qytetar mund të realizohet me sukses në mësimin shkollor me realizimin e metodave dhe aktiviteteve për nxitjen e nxënies së thelluar me mirëkupti dhe rezonim, bashkëpunim, punë në grupe, si dhe hulumtim të pavarur dhe zbulim të diturisë. Arsimtarët e arsimit qytetar duhet të kontribuojnë në krijimin e klimës demokratike në shkollë, përmes aktiviteteve hulumtuese, punëtorive të projekteve, nxënësit të shprehin mendimin e tyre, të pranojnë vlera, të edukohen në frymën e bashkëpunimit, humanitetit, empatisë, komunikimit të padhunshëm, mosdiskriminimit dhe respektimit të diversiteteve.

Mësimi i arsimit qytetar planifikohet, organizohet dhe realizohet rregullisht me fondin e parashikuar të orëve që është përcaktuar me planin mësimor. Nxënësit në mësim notohen me notë numerike që ka ndikim në suksesin e përgjithshëm.



***Rekomandime për përdorimin e fondit vjetor të orëve (planifikim orientues i orëve mësimore sipas temave dhe përmbajtjeve mësimore).***

Rekomandimet për fondin vjetor të orëve janë dhënë si orientim, së bashku me qëllimet konkrete, rezultatet nga nxënia dhe temat/përmbajtjet, gjë që, gjithsesi, nuk duhet të kufizojë shpërndarjen e tyre, sipas nevojave gjatë realizimit. Përdorimin e ndryshëm të orëve duhet ta vlerësojë arsimtari i lëndës, sipas të arriturave të nxënësve të tij, gjegjësisht sipas ndryshimeve në cilësinë e diturive dhe aftësive që ata i arrijnë.

***Rekomandohet përdorimi i këtyre mjeteve mësimore:***

- tekst shkollor për lëndën përkatëse, i aprovuar nga ministri;
- burime tjera të nxënies në mjedisin e drejtpërdrejt, vizitë në institucione të specializuara dhe bashkëpunim me persona profesional;
- enciklopedi, fjalorë, revista, shtyp ditor, akte ligjore, dokumente ndërkombëtare;
- internet, softuerë të popullarizuar të ilustruar arsimor dhe përmbajtje dixhitale;
- mjete audio-vizuale dhe mjete tjera përkatëse për lëndën.

## **6. NOTIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE**

Gjatë mësimit ndiqen dhe vlerësohen rregullisht të arritura e nxënësve. Mblidhen treguesit për të arriturat e qëllimeve të vendosura përmes matjes së rezultateve nga nxënia. Krahas kësaj ndiqen aktivitetet për nxënie, ndërtimi i qëndrimeve dhe mendimeve personale për çështje të caktuara nga materiali mësimor, motivimi për nxënie, bashkëpunimi me të tjerët, angazhimi i nxënësve në bashkësinë. Për gjithë këtë nxënësit marrin informacione dhe udhëzime kthyesë për përmirësimin e punës dhe të arriturave të tyre. Përdoren metoda dhe teknika të ndryshme të notimit formativ dhe sumativ.

Nxënësit duhet prej përpara të jenë të informuar për kriteret për nota sumative dhe numerike. Në to nuk duhet të përfshihen qëndrime të nxënësve për çështje të caktuara shoqërore.

Bëhet rregullisht informimi i secilit nxënës, si dhe i prindërve për të arriturat e nxënësit. Notimi është pjesë përbërëse e planifikimit të arsimtarit për mësimin dhe nxënien.

## **7. KUSHTE HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR**

Programi mësimor i arsimit qytetar për klasën e IX-të në raport me kushtet hapësinore mbështetet në Normativin për hapësirë, pajisje dhe mjete mësimore për shkollë fillore nëntëvjeçare, të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendimin nr. 07-1830/1 të datës 28.02. të vitit 2019.

## **8. NORMATIV PËR KUADËR MËSIMOR**

Mësimin nga lënda mësimore arsim qytetar e mban arsimtari që ka mbaruar:

- studime të Sociologjisë (VII/1 ose 240 EKTS) me përgatitje të përvetësuar përkatëse pedagogjike-psikologjik dhe metodike të institucioneve të akredituara të arsimit sipëror,
- studime të Historisë (VII/1 ose 240 EKTS) me përgatitje të përvetësuar përkatëse pedagogjike-psikologjik dhe metodike të institucioneve të akredituara të arsimit sipëror,
- studime të Filozofisë (VII/1 ose 240 EKTS) me përgatitje të përvetësuar përkatëse pedagogjike-psikologjik dhe metodike të institucioneve të akredituara të arsimit sipëror.

## **9. FILLIM I ZBATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR**

Data e fillimit: **1.9. viti 2019.**

## 10. NËNSHKRIM DHE DATË PËR PËRCAKTIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programin mësimor nga **Arsimi qytetar** për klasën e IX-të të arsimit fillor nëntëvjeçar, me propozim të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, e përcaktoi ministri i Arsimit dhe Shkencës.

**MINISTËR**

**Dr. Arbër Ademi**

---

Përpiloi: grupi punues, me vendimin nr. 02-56/1 më 25.4.2018

Koordinator: mr. Oliver Stanojoski

Kontrolloi: Trajçe Gjorgjijevski, Udhëheqës i departamentit

Aprovoi: mr. Mitko Çeshllarov, Udhëheqës i sektorit